

FJALA E DEPUTETIT XHEMAL QEFALIA

E ENJTE DATA 16 MARS 2023

Të nderuar kolegë,

Kjo është një marrëveshje, e cila, pa dyshim, kërkon edhe votat e opozitës dhe unë jam i bindur që do të ndodhë, pasi vjen në kuadër të forcimeve të marrëdhënieve midis dy vendeve tona, aq më tepër në kuadër të një bashkëpunimi të shkëlqyer që kemi me rajonin përkatës. Duke marrë shkas nga parafolësit, të cilët u ndalën te problemet e sigurisë në vend, më lejoni, të nderuar kolegë, që t'u referohem disa statistikave, të cilat flasin qartë për nivelin e sigurisë në vend tani që po drejton kjo mazhorancë dhe në kohën kur keni drejtuar ju. Për këtë po u referohem shifrave, të cilat janë konkrete dhe dalin në buletin publik që paraqet Ministria e Brendshme, pra janë shifra që nuk janë sajuar dhe nuk kanë nevojë as për vulë dhe as për ndërrim skuadre nga një parti në tjetrën. Çfarë thonë shifrat? Dëgjova këtu kolegen Çupi, e cila tha se ka rënë perceptimi i qytetarëve për sigurinë në vend. Jo, zonjë, e keni shumë gabim. Në kohën që drejtonit ju, mazhoranca juaj, numri i telefonatave drejt 129-ës, numri publik për qytetarët që kanë nevojë, ka qenë 156 mijë, ndërsa në vitin 2022 ka arritur në 1 milionë e 261 mijë e 988. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon besimin që kanë qytetarët te policia. Nuk është më një polici e braktisur, një polici e keqveshur, një polici e patrajtuar në uniformë, një polici e patrajtuar në pagë. Tendenca dhe këmbëngulja e kësaj qeverie dhe e kësaj mazhorance është që policia të jetë e shtetit dhe jo e partive politike. Ju ndoqa sot në ligjëratat tuaja, ku i kërkonit llogari qeverisë pse është dënuar ajo zonja lehonë. Normalisht, edhe unë si qytetar e ndiej që ajo zonja nuk kishte pse të ishte prapa hekurave, por tashmë ka ndryshuar filozofia e drejtimit, tashmë Kryeministri nuk është edhe kryepolic, edhe kryegjyqtar, edhe Kryeministër, institucionet janë të ndara, dhe këtë gjë ju nuk doni ta kuptoni.

Tashmë nuk e vendos masën e arrestit me burg apo arrest shtëpie Kryeministri dhe qeveria, por sistemi gjyqësor. A ka vërejtje për ta riparë, po, ka, sepse, nëse nuk do të kishte, nuk do ta bënim reformën në drejtësi. Është vullneti i kësaj mazhorance që ka ndodhur kjo reformë në drejtësi. A ka ende gjyqtarë që japin një masë të tillë dhe duhet të vihen përpara përgjegjësisë edhe nga inspektorati përkatës? Natyrisht që ka. Së dyti, numri i vrasjeve që kanë ndodhur gjatë qeverisjes suaj ishte me tre shifra, sot ai është ulur, u bënë dy-tre vjet që ka vajtur në dy shifra. Kjo tregon qëndrueshmërinë e kësaj policie. Meqenëse nuk dua të zgjatem shumë, dua të them diçka që u përmend për Kryeministrin Rama. Çfarë nuk bëtë, erdhët këtu, kapët foltoren, nxorët çdo të enjte njerëzit në protestë duke protestuar. Për çfarë protestonin? Që të vinte Kryeministri. Këtu thoshit se Kryeministri është fshehur, madje thatë se është fshehur në "Sarajet e Surrelit". Unë jam deputet i asaj zone, në të cilën jeton edhe Kryeministri, dhe thoni se atje është një vilë e stërmadhe, madje sot ish-kryeministri Berisha tha se është me dhjetëra metra nëntokë. Çfarë mendoni ju se qytetarët nuk e dinë këto gjëra? Edi Rama nuk ka vilë as te Gjiri i Lalëzit, nuk ka vilë as te Kodra e Priftit. Me këtë rast, më lejoni t'ju falënderoj në emër të banorëve të Surrelit, sepse e keni bërë Surrelin sikur të jetë San Francisko! Më kanë thënë banorët që t'i falënderoj deputetët, sepse më në fund i njohët! Kështu që, faleminderit që e përmendni aq shpesh Surrelin! Ju keni edhe një gjë tjetër, ndërkohë që thoni se Rama është izoluar, Rama sot takoi komisionerin e BE-së, para ca ditësh takoi Kancelarin e Gjermanisë. Jo vetëm kaq, por iu tha se samitin që bëri më 6 dhjetor ta bëjë edhe për Ballkanin Perëndimor. Prandaj, bëhuni bashkë,

jo për t'u futur te "Shtëpia e lirisë", por në apartament, sepse jeni zvogëluar pak tani, me ose pa vulë, dhe hajdeni të ballafaqohemi më 14 maj. Faleminderit!